



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1004/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, në çështjen përmbaremore të kreditorit avokat Agron Rrecaj B.I, NUI ..., me seli ne rr."Johan Vahn" nr.33 Prishtinë, ndaj debitorit Banka për Biznes sh.a, NUI..., me adresë rr." Ukshin Hoti" nr.128 me Prishtinë, me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1424/22 të datës .22.05.2023, me datën 10.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Agron Rrecaj B.I, NUI ..., me seli ne rr."Johan Vahn" nr.33 Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomës se Shkalles se Parë KPPP.nr.1424/22 të datës 22.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1424/22 të datës .22.05.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Banka për Biznes sh.a, NUI..., me adresë rr." Ukshin Hoti" nr.128 me Prishtinë, e paraqitur ndaj urdhrin përmbaremore P.nr.014/21 dt.21.01.2021, i lejuar nga Përmbareuesja Private Rrezarta Metaj, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes thelbësore te dispozitave te LPK nga neni 182 par.2 pika n) lidhur me te drejtën kushtetueses për vendim te arsyetuar, vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike nga neni 183 par.1 te LPK dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale nga neni 184 te LPK, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj, prapësimin debitorit ta refuzoj si te pabazuar dhe urdhrin përmbaremore ta vërtetoj.

Përgjigje ne ankesën e kreditorit ka ushtruar debitori me pretendimin se arsyet e dhëna nga kreditori nuk qëndrojnë, andaj propozon qe gjykata e shkalles se dytë ta refuzoj ne tërësi ankesën e kreditorit dhe aktvendimi i atakuar te vërtetohet.

Dhoma e Shkalles e Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori avokat Agron Rrecaj B.I, NUI ..., me seli ne rr.”Johan Vahn” nr.33 Prishtinë, me datën 21.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Banka për Biznes sh.a, nui..., me adresë rr.” Ukshin Hoti” nr.128 me Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.054/20 dt.14.12.2020. Përmbartuesja Private Rrezarta Metaj, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.014/21 dt.21.01.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura t’ia paguaj ë shumën prej 1,015.62 euro, me kamatë ligjore prej 8%, vjetore nga data 31.12.2020 e deri ne pagesën definitive, si edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 01.02.2021, me pretendimin se propozimi për përmbartim duhet te hudhet si i palejueshëm, propozimi për përmbartim nuk përmban as origjinalin e as kopjen e vërtetuar te dokumentit të besueshëm ne bazë te cilit është lejuar përmbartimi, dokumenti i besueshëm nuk është i bazuar ne rregullat qe përcaktojnë dokumentin e besueshëm, urdhri përmbartimor është lëshuar me keqbesim, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe te anulohet urdhri përmbartimor.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka, ushtruar kreditori me datën 05.02.2021, me arsyetimin se kreditori e ka lëshuar faturën nr.054/20 dt.14.12.2020 ne emër te debitorit te cilën faturë po te njëjtën ditë ka tentuar qe t’ia dorëzoj ne kopje fizike –original debitorit por i njëjti ne mënyrë arbitrare nuk ka dashur ta pranoj te njëjtën. Debitori e ka pranuar faturën me datën 15.12.2020 dhe te njëjtën ka qenë i obliguar ta paguaj me se largu me datën 30.12.2020 por qe ende nuk e ka paguar. Fatura nr. 054 ne cilësi te dokumentit te besueshëm i përmbush te gjitha kriteret e përcaktuara me legjislacion tatimor te Republikës se Kosovës andaj si e tille e njëjta nuk përmban asnjë mangësi ligjore ne kuptim te këtyre dispozitave, propozon qe gjykata prapësimin e debitorit t refuzoj si te pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosove- Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1424/22 dt.22.05.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbartimor dhe ka përfunduar ne tërësi përmbartimin ne këtë çështje përmbartimore, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ne arsyetim te aktvendimit, Gjykata e shkalles se parë ka arsyetuar se ne rastin konkret fatura ne.054/20 dt.14.12.2020, ne bazë te cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 te LPP. Gjykata gjënë se dokumenti –fatura ne bazë te cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm për faktin se kjo faturë ne rastin konkret është lëshuar ne mënyrë te njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit-debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga i njëjti, pra dokumenti mbi te cilin është lejuar përmbartimi nuk ka tipare te përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri përmbartimor duhet te anulohet dhe procedura te përfundohet ne tërësi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes. Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim

me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Konsideron se fatura nr.054/20 dt.14.12.2020 mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm. Neni 29 par.3 te LPP përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar“*. Ne rastin konkret nga fatura del qarte se e njëjta nuk është përshtatshme për përmbarim, sepse nuk është e nënshkruar nga debitori, e vulosur nga ana e tij dhe ne këtë mënyrë konsiderohet se nuk është pranuar ne mënyrë te rregullt nga i njëjti. Sa i përket pretendimit te kreditorit se gjykata e shkalles se parë me rastin e nxjerrjes se vendimit nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, kjo gjykatë vlerëson se ky pretendim nuk qëndron sepse ne shkresat e lëndës nuk ka prova se debitori ka pranuar ne mënyrë te rregullt faturën nga kreditori, ashtu qe e njëjta është lëshuar ne mënyrë te njëanshme nga kreditori e kjo sepse edhe propozimit për përmbarim i është bashkëngjitur e panënshkruar dhe pavulosur, pra kreditori nuk ka ofruar prova ne argumentim te pretendimeve te tij ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP. Gjykata e shkalles se dytë analizoi edhe pretendimet tjera te debitorit por vlerësoi se te njëjtat janë të pabazuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe prandaj edhe te njëjtat i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e gjykatës se shkalles se parë e vërtetoi.

Marrë parasysh parimin e rigorozitetit formal, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1004/23, me datë 10.11.2023

Gjyqtari,
Dren Rogova